



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 3619 Prot.

Tiranë, më 14.12.2025

V E N D I M

Nr. 76 datë. 14.12.2025

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. ANTONELA LLESHI NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 27.05.2024.

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi - Kryetar

Znj. Lindita Ziguri – Anëtar

Znj. Joana Sorraj - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Eljona Bylykbashi

Znj. Zonje Shelqizi

Znj. Amanta Jasa

Në mbledhjen e datës 16.12.2025, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

Znj. Antonela Lleshi

OBJEKTI: Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Antonela Lleshi në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".
4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret

e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 10.11.2025, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për Znj. Antonela Lleshi dhe me komunikimin e datës 11.11.2025, njoftoi kandidatin për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.

5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.63, datë 11.11.2025 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit znj. Antonela Lleshi për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në datë 20.11.2025, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 4 (katër) vendet vakante.

II. Vlerësimi i Komitetit

7. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit znj. Antonela Lleshi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

1. Meritat profesionale (50) pikë

A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë

8. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Znj. Antonela Lleshi disponon këto të dhëna:

Përvoja profesionale:

- Jurist, RAMKU shpk, janar 2005 – qershor 2009;
- Specialist në Sektorin e Regjistrimit të Lejeve/Licencave dhe Autorizimeve dhe Specialist në Drejtorinë e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike, maj 2009 – në vazhdim referuar datës së aplikimit.

Arsimimi:

- Diplomë “Master i shkencave”/Jurist, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, periudha 2000-2004;

Kualifikimet pasuniversitare:

- Diplomë/“Master i nivelit të dytë” në degën “Pushtet Ekzekutiv”, ALBANIAN UNIVERSITY (ish U.F.O UNIVERSITY, periudha 2009 – 2010.

Trajnime, sipas jetëshkrimit:

Periudha : Janar 2003-në vazhdim

- Tema: Njohja me institucionet komunitare dhe me pushtetin vendimmarrës.
Në këtë sesion informues u trajtuan: Institucionet e Bashkimit Evropian; Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Këshilli i Ministrave, Komisioni Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë e BE; Institucionet që veprojnë në bazë të Traktateve, përbërja dhe roli që përcaktohen në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian; Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni të cilët mbështeten nga Komiteti Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve të cilët veprojnë me cilësi Këshillimore; Procesi legjislativ dhe pushteti vendimmarrës; Banka Qendrore Evropiane dhe Gjykata e Audituesve.
- Tema: Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore në BE;
Në këtë sesion informues u trajtuan: E drejta evropiane dhe aktet juridike kryesore që veprojnë në Bashkimin Evropian; Institucionet e BE që përfshihen në procesin e miratimit të akteve juridike; Analiza e procedurave të hartimit dhe të miratimit të akteve juridike si rregulloret dhe direktivat; Analiza e shembujve konkrete të disa prej akteve juridike të fushave të ndryshme; Procedurave të zakonshme ligjore dhe procedurave të veçanta për miratimin e akteve juridike në BE.
- Tema: Lëvizja e lirë në BE dhe të drejtat që gëzohen lidhur me të ETIAS dhe zhvillimet e fundit. Në këtë sesion informues u trajtuan: Aspektet themelore të lëvizjes së lirë të personave në Bashkimin Evropian; Dy regjimet e ndryshme juridike: për shtetasit komunitarë (direktiva 2004/38/EC) dhe shtetasit jo

komunitarë që qarkullojnë brenda Hapësirës Shengen (rregullat Shengen dhe aktet e tjera juridike përkatëse); Kushtet dhe procedurat konkrete për ushtrimin sa më efektiv të kësaj të drejte themelore; Një vemendje e veçantë do i kushtohet të drejtave që përfitojnë individët; Do të analizohet gjithashtu koncepti ETIAS, një element shumë i rëndësishëm këtë kohë për lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në BE.

- Tema: Hapësira administrative Evropiane dhe impakti i saj në administratë.
Në këtë sesion informues u trajtuan: Elementet thelbësore të Hapësirës Administrative Evropiane të Bashkimit Evropian; Procedurat administrative për zbatimin direkt të rregullave të saj në një sërë fushash – si p.sh politika e konkurrencës, politika tregtare, ndihmat shtetërore, aksesit në BE dokumente, shërbimi civil i BE; Bërthama e konsoliduar të procedurave administrative evropiane, (procedurat e qëndrueshme administrative të BE-së) përfshirë dhe të drejtat procedurale të zbatueshme për qytetarët kur kanë të bëjnë drejtpërdrejt me administratën e BE-së dhe /ose të Shteteve Anëtare.
- Tema: Njohja me kartën e të drejtave themelore të BE dhe influenca e saj tek ne.
Në këtë sesion informues u trajtuan:Karta e të drejtave themelore të BE; Të drejtat që garanton kjo Kartë, zhvillimin e saj ndër vite si dhe interpretimin e evolues të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; Analiza e thelluar e disa të drejtave që gjenden në Kartë dhe që duhet të përmirësohen edhe në vendin tonë, si në nivel kushtetues ashtu edhe në nivel ligjor.
- Tema "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë", dt. 28 maj 2024
Qëllimi i këtij trajnimi është njohja me parimet bazë të sigurisë kibernetike dhe mënyrën se si të sillemi për një përdorim të sigurt të internetit. (trajnim me certifikatë, - 26.06.2024)
- Tema: Lëvizja e lirë e kapitalit në Bashkimin Evropian;
- Tema: Reforma territoriale, decentralizimi dhe vetëqeverisja vendore
- Tema: Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet përparësitë e normave juridike
- Tema: Njohja me aktet juridike evropiane
- Tema: Strategjia e re e decentralizimit dhe roli i ministrit të shtetit për vetëqeverisjen vendore
- Tema: Raporti i të drejtës Evropiane me të drejtën kombëtare
- Tema: Llojet e kontratave të punës, përfundimi i marrëdhënieve të punës dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës
- Tema: Lëvizja e lirë e personave
- Tema:Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim, zhvilluar në datën 18 prill 2024 me kohëzgjatje 6 orë, organizuar nga shkolla Shqiptare e Administratës Publike. **Me certifikatë.**

- Tema: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike
- Tema: Raporti i të drejtës Evropiane me të drejtën kombëtare
- Tema: Etika dhe dilemat etike
- Tema: Risitë e legjislacionit për etikën
- Tema: Konflikti i interesit, si një formë e korrupsionit
- Tema: Parimet e menaxhimit të konflikteve të interesit- një vështrim krahasues legjislativ
- Tema: Legjislacioni për shoqëritë tregtare
- Tema: Drejtësia, liria dhe siguria
- Tema: Hartimi legjislativ.
(Trajnim i cili zhvillohet nga Ministria e Drejtësisë, EURALIUS dhe JUSTAL, trajnimi zhvillohet për një periudhë 9 javore në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, trajnim në vazhdim. Certifikatë ku evidentohet kohëzgjatje 27 orë, zhvilluar në 25 prill – 27 qershor 2024, organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE Justal. Me certifikatë.
- Tema: Antikorrupsioni organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, me kohëzgjatje 6 orë, zhvilluar në data 21 dhe 24 qershor 2024, me certifikatë.

Periudha : 09/05/2009-09/06/2009

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Për One Stop Shop dhe Sistemin (Konkretisht për QKL, Aktualisht QKB) Kujdesin ndaj klientit, organizuar nga USAI dhe QKB (ish QKL). (Trajnim pa certifikatë);

Tituj profesionalë:

- Titulli “Avokat” me liçensë me nr.2758, në vitin 2005, Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Gjuhë të huaja:

- Anglisht e shprehur në jetëshkrim me nivel zotërimi (të kuptuarit 7, të folurit 7, shkrimi 7) me dëshmi të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, ku rezulton mbrojtja më datë 26.04.2008 me notë 7 (shtatë); Italisht me nivel zotërimi (të kuptuarit 7, të folurit 7, shkrimi 7), me dëshmi të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, ku rezulton mbrojtja më datë 25.02.2006 me notën 7 (shtatë) dhe Frënge me nivel zotërimi (të kuptuarit 6, të folurit 6, shkrimi 6), me dëshmi të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës ku rezulton mbrojtja më datë 29.04.2006 me notën 6 (gjashtë).

Historiku Arsimor (2) pikë

9. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të

barasvlershme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

10. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Antonela Lleshi;
- Ka përfunduar Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 2004 duke u diplomuar “*Jurist*”. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 7.89.
11. Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të secilin kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
12. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 7.89, e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin Znj. Antonela Lleshi me **0 pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë

13. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve të tjera, veçanarisht me një kohëzgjatje minimale 2 javore dhe të shoqëruar me një certifikatë vlerësimi.
14. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
- **Tituj akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” dhe Gradë shkencore “Doktor”-**
15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati znj. Antonela Lleshi të ketë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të nenit 60, 61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Prof., Pro/asoc., apo Dr, Phd.).
16. Për këto arsye, për këtë kriter vlerësimi, që lidhet me titujt dhe gradat, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Antonela Lleshi me **0 pikë**.

- **Studime afatgjata**

17. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton se kandidatja Antonela Lleshi ka fituar:

- Diplomë/“Master i nivelit të dytë” në degën “Pushtet Ekzekutiv”, ALBANIAN UNIVERSITY (ish U.F.O UNIVERSITY, periudha 2009 – 2010.

18. Për këto arsye, për këtë kriter vlerësimi, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Antonela Lleshi **me 1.5 pikë**.

- **Lista dhe lloji i trajnimeve -**

19. Për këtë kriter, referuar shtojcës nr. 1 të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, burimet lidhen me informacione dhe dokumente zyrtare konkrete për pjesëmarrje në – trajnime dhe kurse profesionale, mbi bazën të cilave do të vlerësohen indikatorë të tillë si vëmendja, angazhimi, korrektësia e ndjekjes së veprimtarive që mundësojnë rritjen e shkallës së profesionalizmit në ushtrimin e veprimtarisë profesionale.

20. Në rastin konkret referuar të dhënave në jetëshkrimin e kandidates, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Znj. Antonela Lleshi me **1 pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë

Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se:

21. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin znj. Antonela Lleshi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **3 pikë**.

22. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë “Historiku arsimor dhe profesional”, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **5.5 pikë**.

B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pikë

23. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi i **përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriterë vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose

rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilin kandidon.

24. Për vlerësimin e kriterit në fjalë, Komiteti do të mbështetet në burime vlerësimi si jetëshkrimi, punime dhe dokumente profesionale të kandidatit, të përgatitura në përmbushje të funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës, ku përfshihen por pa u kufizuar vetëm në to: vendime gjyqësore, kërkesa për gjykim, pretenca, padi, parashtrësia të mbrojtjes së çështjes, mjete të kundërshtimit të vendimeve, akte administrative dhe parashtrime në praktika administrative të përgatitura me kontribute nga kandidat, përfaqësime të ndryshme të interesave publike ose private përpara organeve të drejtësisë ose institucioneve brenda apo jashtë vendit, prezantime, artikuj dhe publikime shkencore e profesionale; dokumente ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Inspektori; dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional; dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare; statistika profesionale nga institucione kompetent.
25. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor jomagjistrat.
26. Në rastin e kandidatit Znj. Antonela Lleshi, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite.

Vlerësimi sasior - (5) pikë

27. Vlerësimi sasior realizohet nëpërmjet informacionit të detajuar në jetëshkrim ose në dokumente të tjera të cilat përmbajnë të dhëna statistikore për sasinë dhe tipologjinë e punimeve dhe dokumenteve profesionale të kandidatit, të përgatitur në kuadër të përmbushjes së funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilin kandidon.
28. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, nga ana e kandidatës janë paraqitur dokumentet profesionale të përzgjedhur nga vetë kandidatja Znj. Antonela Lleshi, si më poshtë:
- Dokumentet profesional të paraqitur:

- Konkluzione përfundimtare, datë 17.07.2019, për çështjen gjyqësore me nr. akti 2118 dhe me palë paditës “Gentian Ramku” dhe i paditur “Drejtoria e Përgjithshme e Financave dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë, etj dhe objekt: Shfuqizimin e aktit administrativ Në këtë akt rezulton në fund nënshkrim poshtë emrit Gentian Ramku dhe nënshkrimi pranë emrit Antonela Lleshi i cili rezulton të jetë i njëjtë në çdo fletë të këtij akti. Në të dhënat për paditësin, nuk rezulton që kandidatja të jetë cilësuar si përfaqësuese; Vendimi nr. 1082 datë 23.12.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit mbi gjykimin e çështjes me paditës Gentian Ramku, ku është vendosur ndryshimi pjesërisht i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë.
- Rekurs i QKB, Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike, me datë 17.09.2018, Rekurs ndaj vendimit nr. 2931, datë 13.07.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit duke kërkuar – Prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2931, datë 13.07.2018 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4460, datë 03.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Në fund të aktit të rekursit, në konkluzionin përkatës është shënuar si përfaqësuese me autorizim për Qendrën Kombëtare të Biznesit, Antonela Lleshi;
- Ankim i QKB, Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike, me datë 04.01.2019, ankim ndaj vendimit nr. 4438, datë 06.12.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Në fund të aktit, në konkluzionin përkatës është shënuar si përfaqësuese me autorizim për Qendrën Kombëtare të Biznesit, Antonela Lleshi;
- Prapësimet e QKB, në çështjen administrative me nr. 4292 regjistri themeltar, me të paditës Shkolla Jopublike “Skënderbej”, të paditur QKB, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë – MASR, me objekt: Detyrimin e të paditurit QKB për miratimin në heshtje të kërkesës të subjektit ... për hapjen e shkollës jopublike Skënderbej dhe pajisjen me licencë arsimit mesëm i lartë. ... Në fund të aktit të është shënuar si përfaqësuese me autorizim për palën e paditur, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Antonela Lleshi;
- Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 2035 vendimi datë 28.05.2018, me paditës Trëndafil Gjoshi, person fizik dhe të paditur ndër të tjera QKB, ku evidentohet emër i kandidates, por është shoqëruar me Kartelë shoqëruese e praktikës të AKB datë 08.06.2018 lidhur me një vendim të administruar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me nr. protokolli 4343/5 datë 08.06.2008 ku është kaluar për trajtim kandidatit.
- Urdhër nr. 26 datë 28.02.2023 të QKB, Drejtorit të Përgjithshëm për një ndryshim në urdhërin datë 16.12.2022 për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e formularëve të aplikimit për regjistrin tregtar, regjistrin e pronarëve përfutues dhe regjistrin kombëtar të licensave/autorizimeve/lejeve ku kandidatja Antonela Lleshi është pjesë grupi të cilët kanë si detyrë rishikimin e formularëve aplikimit dhe dorëzimin e tyre brenda datës 15.03.2023.
- Shkresë e datës 18.10.2023 e QKB, Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike, Drejtori i Përgjithshëm, me lëndë “Mbi përmirësimin e Shërbimeve

online të QKB” drejtuar ndër të tjera edhe kandidates në cilësinë e specialist, Sektori i Licensimit të Biznesit.

- Urdhër nr. 134 datë 18.10.2023 e QKB, e Drejtorit të Përgjithshëm, Në vijim të urdhrit të Ministrit nr. 231 datë 05.10.2023 “për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e vlerësimit të legjislacionit në funksion të procesit të derregullimit. Në grupin e punës përfshihen edhe Antonela Lleshi për regjistrin e Licensave, në cilësinë e specialistet Sektori i Licensimit të Biznesit.

29. Gjithashtu nga ana e kandidates janë sjellë letër reference nga drejtorët/përgjegjësit e sektorëve ku ka punuar/punon, ku ndër të tjera është theksuar, ndonëse e pashoqëruar me dokumente/akte (përveç atyre të cituar si më sipër të sjellë nga vetë kandidati), si ndër detyrat kryesore të saj, marrja pjesë në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit ku QKB është palë në proces, duke vijuar më tej me detyrat e përgatitjes së kërkesë padive, prapësimeve, kundërshtimeve, provave, ankimeve, kundër ankimeve, rekurseve, kundër rekurseve, zënie afati, kërkesa për rivendosje në afat, përgatitje e shkresave, kthim përgjigjeve, kthim përgjigje të ankimeve, përgatitja e projektligjeve, projektakteve të QKB dhe atyre sektoriale, përditësimi i legjislacionit, etj.
30. Mbështetur në këto të dhëna/dokumente në gjendjen që paraqiten dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale, në konsideratat e veprimtarisë së institucionit për të cilin kandidon, Komiteti bazuar në orientimet përkatëse të metodologjisë së vlerësimit, çmoi ta vlerësojë kandidatin Znj. Antonela Lleshi për këtë kriter ligjor vlerësimi me **2.5 pikë**.

Vlerësim cilësor - (25) pikë

31. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e saj në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
32. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati Znj. Antonela Lleshi ka paraqitur në formën e sipërcituar, të dokumentacionit që ajo ka vlerësuar dhe që janë realizuar në funksion të përmbushjes së detyrës së saj të fundit në kohën e aplikimit për këtë vend vakant.
33. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati Znj. Antonela Lleshi, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikezimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e dokumentacionit sa më sipër, duke u mbështetur mbi indikatorë

shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).

34. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizioni, si dhe qartësia.

- **Origjinalitet dhe/ose impakti - (6) pikë**

35. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është “**Origjinaliteti dhe/ose impakti**”. Nisur nga profili profesional i kandidatit Znj. Antonela Lleshi, përmbajtja e dokumentacionit të analizuar dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës, si dhe intervistën e zhvilluar para Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, rezulton se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve në fushën e operimit.

36. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin “**Origjinaliteti dhe impakti**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3.5 pikë**.

- **Aftësitë analitike - (6) pikë**

37. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “**Aftësitë analitike**”, Komiteti duke u përqëndruar në arsyetimin e akteve përkatëse të dorëzuar, si dhe intervistën e zhvilluar, arrin në konkluzionin se kandidati zotëron aftësi profesionale për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

38. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin “**Aftësitë analitike**”, Komiteti vlerëson kandidatin me **3.5 pikë**.

- **Aftësitë kërkimore - (4) pikë**

39. Në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati, ku vlerësohet aftësia e kandidatit për të kërkuar, organizuar dhe përdorur informacionin e duhur në funksion të përmbushjes së detyrave të saj. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Znj. Antonela Lleshi në dosjen e kandidimit, në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 pikë**.

- **Saktësia dhe precizioni - (5) pikë**

35. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kënaqshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.

40. Në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 pikë**.

- **Qartësia - (4) pikë**

41. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tij profesionale, kandidati e ka strukturuar tematikën dhe problemin në një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë, si dhe përdorimin e terminologjisë profesionale duke përdorur saktë rregullat gramatikore dhe atyre të sintaksës, me qëllim orientimin e lexuesit dhe ruajtjen në fokus të kuadrit të plotë. Në rastin konkret, nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të qëndrimit të tij në raport me çështjet që trajton.

42. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin **3 pikë**.

43. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **15 pikë**.

44. Në përfundim, të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë “**Kualifikim i përgjithshëm profesional**”, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **17.5 pikë**.

C. Kualifikimi shtesë profesional - (10) pikë

Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë

45. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Burimet në të cilat mbështetet janë jetëshkrimi, dokumente zyrtare për angazhime profesionale; dokumente, ndërmjet atyre të përzgjedhura nga vetë kandidati, që dëshmojnë angazhimin, ekspertizën dhe ndikimin e angazhimit; informacione dhe dokumente zyrtare konkrete mbi pjesëmarrje në veprimtari shkencore, të hartimit të legjislacionit dhe në veprimtari të tjera profesionale.

46. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidateve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban

parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara në urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.

47. Veprimtaria profesionale e kandidatit Znj. Antonela Lleshi referuar dokumentacionit të paraqitur në cilësinë e përfaqësues së QKB-së në çështjet gjyqësore e pasqyruar në aktet përkatëse të sipërcituara dhe veprimtarisë në tërësi të saj, referuar edhe referencave vlerësohet si një veprimtari që ka lidhje me rolin dhe veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
48. Për sa më sipër, Komiteti pasi shqyrtoi dokumentet profesionale të depozituara në dosjen e kandidimit dhe të analizuar më sipër lidhur me rëndësinë që ato mbartin që ato mbartin përsa i përket shërbimit të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të dhënat e jetëshkrimit, referencat si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, konkludon se për kriterin e “Përvojës dhe cilësisë profesionale që a ka ushtruar në raport me rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, kandidati Znj. Antonela Lleshi të vlerësohet me **3 pikë**.

Angazhime profesionale shtesë - (3) pikë

49. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Znj. Antonela Lleshi, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, krahas atyre që janë përmendur në këtë vendim dhe që lidhen me fitimin e titujve të tjerë profesionale, krahas atij të “juristit”, dhe konkretisht:
- Titulli “Avokat” me licensë me nr.2758, në vitin 2005, Dhoma Kombëtar e Avokatisë.
50. Për këtë arsye Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “Angazhimeve profesionale shtesë”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **1 pikë**.
51. **Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë “Kualifikim shtesë profesional”, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me 4 pikë.**
52. **Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë “Meritat Profesionale”, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me 27 pikë.**

2. Merita morale-(25) pikë

53. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kriterë vlerësimi edhe “*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve*” dhe “cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.
-
54. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

55. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

Integriteti etik e moral - (15) pikë

56. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërmbytje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.
57. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me koleget, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.
58. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlerëson kandidatin me **15 pikë**.

Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë

59. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.
-
60. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati Znj. Antonela Lleshi gëzon, rezulton se pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar disa letra reference si nga drejtorë/përgjegjës sektori dhe kolegë në sektorët ku kandidatja

ka punuar dhe punon, në të cilat ndër të tjera shprehet për respektin maksiman që gëzon si në aspektin njerëzor, ashtu edhe në atë profesional të të gjithë kolegëve të saj, si edhe të personave, subjekte e organizata që kanë lidhje me QKB. Lidhur me këtë të fundit ka sjellë dy letër rekomandimi të Përgjegjës sektorit në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minierave dhe Industrisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në të cilat shprehet për kandidaten për seriozitet, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale, si dhe aftësi komunikuese.

61. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e saj përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësiwe ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues “të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **8 pikë**.

Angazhimi në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë

62. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga dokumentacioni i marrë gjatë procedurës së verifikimit, Komitetit i rezulton se kandidati ka dorëzuar – konfirmim pjesëmarrje nga Fondacioni Klinika Orthodhokse e Ungjillizimit në të cilën shprehet për konfirmim të pjesëmarrjes së kandidates në takimet dhe seminarët e organizuara në klinikë, me fokus “*krijimi i mundësive reale për njerëzit që u përkasin shtresave në nevojë, të cilëve do t’u ofrohen shërbime falas ose ekzaminime me çmime të reduktuara sipas politikave të brendshme të përcaktuara në rregullimin dhe funksionimin e aktiviteteve të këtij fondacioni*”.
63. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 pikë**.
64. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, rezulton se kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **25 pikë**.

3. Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë

65. Ky komponent zbërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:
- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
 - b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
 - c) aftësitë e komunikimit dhe të përfaqësimit publik;
 - d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
66. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriterë vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

67. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatet, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.
68. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysht rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidateve për inspektor.
69. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumenteve me shkrim të letër interesi (2 faqe) dhe letër motivimi (2 faqe) ku kandidati shprehet mbi përvojën profesionale të saj në fushën juridike në hartimin e akteve, projektvendimeve, projektligjeve, hartimin e dokumentacionit të një dosje gjyqësore, hartimin e dosjes së hetimit administrativ si dhe në përgatitjen e shkresave për të gjitha institucioneve (ILDKPI, Prokurori dhe Gjykatë), studimet, tituj dhe eksperiencia, gjuhën e huaja të cilat ajo i cilëson se e kanë pajsur me një mentalitet të fortë analitik dhe aftësi për të ruajtur sfida komplekse.
70. Kandidatja ka paraqitur edhe formular i vlerësimit të punës për vitin 2025, janar, janar – qershor, në të cilat jepen vlerësimet për shqyrtimet e aplikimeve të kryera online, zbatimin e afateve ligjore të shkresave të lidhur me trajtimin e shkresave dhe korrespondencave zyrtare, pjesëmarrëse në grupe pune për përmbushjen e detyrave të ngarkuara brenda afateve të caktuara, sjelljen profesionale, ku ka rezultuar në vlerësimin përfundimtar shumë mirë.
71. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysht edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

Cilësia e platformës dhe e vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë.

72. Nisur nga dokumenti me shkrim letër interesi dhe motivimi (dhe jo Platformë (*sikurse kërkohet në bazë të kriterëve të vlerësimit, në kuptimin formalo-juridik*) dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati paraqiti një nivel të mirë të njohjes dhe përvojës profesionale në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në drejtim të mbrojtjes së parimeve të integritetit, paanësisë dhe etikës dhe të respektimit të procesit të rregullt ligjor.

73. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur” nga kandidatet, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2.5 pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë

74. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësepari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim. Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë në vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.
75. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe intervistës, përmbajtjes së së kërkesës së shprehjes së interesit dhe platformës personale të kandidimit, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi, në lidhje me funksionet dhe detyrat që ajo ka përmbushur më parë në karrierën e tij, si dhe ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti iu referua, përgatitjes së saj profesionale si dhe referencave lidhur me përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në kohë të shpejtë dhe me efektivitet dhe profesionalizëm të lartë.
76. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin **5 pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe e përfaqësimit publik - (5) pikë

77. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
78. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të letrës së motivimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si edhe nga përmbajtja, strukturimi i dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t’u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur.

79. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik dhe për të shprehur bindjet e tij me vetëbesim dhe me etikë.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin **me 3 pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore - (2) pikë

81. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotëroje aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për atë sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për tu përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

82. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, referencat ku përmenden ndër të tjera edhe afatësia e saj për punën në grup, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

83. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore", Komiteti vlerëson t'i caktojë kandidatit **2 pikë**.

84. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **12.5 pikë**.

III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati Znj. Antonela Lleshi vlerësohet në total me **64.5 pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit Znj. Antonela Lleshi, me **64.5 pikë** në lidhje me kandidimin e saj për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Znj. Antonela Lleshi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri



KRYETAR

Elena Pelushi



ANËTAR

Joana Sorraj

